



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.159 dt.21.12.2001

**PER
HEQJEN NGA MJEDISET PUBLIKE TE QYTETIT TE TIRANES TE
SIMBOLEVE PERKUJTIMORE FAMILJARE**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të dt.21.12.2001, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Kulturës për heqjen e Simboleve Përkujtimore të vendosura nga familjarët e tyre në mjedise publike të qytetit të Tiranës, në përkujtim të të afërmeve të tyre, mbështetur në Ligjin Nr.8652, dt31.07.2000 neni 32, paragrafi I dhe II

V E N D O S I

1. Nëpërmjet mjeteve të informacionit publik të sensibilizohet opinioni dhe vetë familjarët për heqjen vullnetare të të gjitha simboleve të qytetit të Tiranës
2. Vetëm pas një afati 2 mujor nga komunikimi, Njësitë Bashkiake dhe Ndërmarrja e Gjelbërimit të bashkërendojnë punën për heqjen e tyre
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Punëve Publike, Drejtoria e kulturës dhe Njësitë Bashkiake respektive
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI

Leonidha TOSKA

